

kasin në çdo shtëpi, vizitojnë çdo njeri: *Ide kolo na okolo* (Sillet vâlja rrotull-o, nr. 95, f. 208).

Njerëzit ndonjëherë rreken për oso punësh që s'janë të tyre, për punë që s'janë të zotët t'i qesin në krye, ndaj fundi i përpjekjes së tyre përfundon keq: *Isla krava na oranje pa usrala gredel* (nr. 117, f. 208).

Njerëzit e ndryshëm për punë të ndryshme kanë përvoja të shumëndurshme, ruajnë doke, zakone që përkojnë me kohën: *Koliko sela, toliko adeta* (Fshat e zanat, nr. 133, f. 209).

Puna që kryhet herët, gjëja që selitet me kohë, jep edhe fryte të hershme: *Rano pile rano poje* (nr. 299, f. 214).

Shquhen me vlerat e tyre, me mendimin filozofik proverbat: *Tija voda breg roni* (nr. 364, f. 216), *Udavljenik se za slamku faća* (nr. 391, f. 217).

Në 16 faqe, jepet një pasqërë historike për fjalët e urta, ndërsa në fund të librit jepet një pasthënie dhe bibliografia e përdorur si dhe fjalori i fjalëve të panjohura.

RAHMI TUDA

KËNGË DASHURIE I, Instituti Albanologjik i Prishtinës, përgatitur nga Rrustem Berisha dhe Myzafere Mustafa, Prishtinë, 1979.

Bleni „*Këngë dashurie I*”, i përgatitur nga Rrustem Berisha dhe Myzafere Mustafa, është vëllimi i pestë i serisë së botimeve të letërsisë popullore që bën pjesë në makroprojektin e Institutit Albanologjik, i cili parashih botimin e 25 blenjve të lëndës folklorike të shqiptarëve të Jugosllavisë. Ky vëllim përfshin 353 këngë dashurie që janë mbledhur në treva të ndryshme nga bashkëpunëtorët e jashtëm dhe nga punonjësit shkencorë të Institutit.

Kënga e dashurisë është një nga llojet shumë të përhapura të lirikës popullore shqiptare. Ajo ka filluar të mblidhet e të botohet që nga mbledhësit e parë të folklorit shqiptar. Këtë lloj të këngëve e gjejmë në të gjitha vëllimet e lirikës popullore shqiptare që janë botuar deri me tash. Mirëpo, ky është libri i parë që në tërësi i kushtohet poezisë popullore të dashurisë dhe përmban vlera të konsiderueshme poetike të lirikës së mirëfilltë popullore. Kur themi lirikë e mirëfilltë kemi parasysh faktin se kënga e dashurisë, ndryshe nga llojet e tjera të lirikës popullore që lidhet me rite e zakone të ndryshme të traditës etnografike e folklorike të popullit, është krijim poetik që ka pikënisje të drejtpërdrejtë ndjenjat e fuqishme të dashurisë së të rinjve.

Dashuria si ndjenjë, që e ka zanafillën e vet që nga fazat më të hershme të zhvillimit të njeriut dhe të raporteve të tij në sferën e krijimit të familjes dhe të ruajtjes së gjinisë

njerëzore, i ka kushtëzuar marrëdhëniet më suptile të afrimit dhe bashkimit të të rinjve të të dyja gjinive. Kjo ndjenjë është manifestuar me tërë fuqinë e vet në një pjesë të madhe të krijimtarisë poetike të traditës popullore. Mirëpo, ajo del e plotë, e pasur me nuancat më të ndjeshme të botës intime të njeriut si dëshirë, ndjenjë, si burim frymëzimi, gëzimi, shqetësimi, malli e nostalgjie, si bukuria madhështore, por edhe tragjike, vetëm në këngët erotike. Këtë e dëshmojnë bindshëm edhe 353 këngët e këtij vëllimi, që janë zgjedhur, seleksionuar e radhitur me kujdesin e duhur nga Rr. Berisha dhe M. Mustafa.

Librit „*Këngë dashurie I*” i paraprin parathënia e shkruar me frymëzim nga Rrustem Berisha. Në këtë parathënie në mënyrë koncize paraqiten veçoritë karakteristike të këngëve të dashurisë, pasuria e tyre tematike-motivore dhe vlerat estetike të kësaj poezie. Autori i parathënies sjell një analizë të plotë lidhur me rrethanat dhe kushtet e krijimit dhe të ruajtjes së kësaj poezie duke pasur parasysh edhe strukturën poetike të krijimeve. Duke u bazuar në poezinë popullore ai i vështron edhe rrethanat sociale dhe etiko-morale të manifestimit të dashurisë, e cila, të paktën në sferën shpirtërore imagjinative e krijuese, i thyen barrierat e shumta të normave e kanuneve karakteristike për rapor-

tet familjare të kushtëzuara nga morali i rreptë patriarkal.

Në përfundim të parathënieve Rrustem Berisha i paraqet edhe tri parimet themelore që janë marrë si kritere me rastin e përpilimit të blenit „Këngë dashurie I”. Duke u nisur nga këto kritere do të përpilimi që të japim një vlerësim pak më të plotë për punën e suksesshme të përpiluesve të këtij vëllimi.

Përpiluesit kanë ndjekur parimin se këngët e dashurisë nuk duhet të ndahen në nënloje e as të grupizohen sipas trevave, sepse ato trajtojnë vetëm tematikën e dashurisë në kontekstin e përgjithshëm shoqëroro-ekonomik dhe kultural të popullit tonë. Duke pasur parasysh se në libër janë paraqitur me proporcione reale tipet e ndryshme të këngëve të të gjitha trevave duke filluar nga rrethinat e Ulqinit, Malësia e Hotit e Grudës, Gusia, nga të gjitha trevat e Kosovës, nga fshatrat e Medvegjës e të Preshevës, nga viset e Maqedonisë Perëndimore deri në pikat më jugore të fshatrave të Strugës e të Prespës, konsiderojmë se ky vëllim përmban vlerat më të shënueshme poetike të këngëve të dashurisë nga të gjitha viset ku jetojnë shqiptarët në Jugosllavi. Ky përfaqësim, siç shihet nga këngët, nuk është formal, por ka pikënisje kriteret e caktuara estetike të përpiluesve. Këngët e dashurisë, përveç karakteristikave të përbashkëta, kanë edhe specifikat e veta regjionale, prandaj mbarështrimi i lëndës ka qenë me siguri një nga preokupimet e veçanta të përpiluesve të këtij bleni. Dilemat e ndryshme lidhur me grupet, llojet e nënlojet, si edhe variantet e ndryshme të këngëve të dashurisë, ata i kanë kanërcyer me sukses, duke evituar klasifikimin e lëndës në bazë të ndarjeve e dallimeve territoriale dhe të ambienteve në të cilat janë krijuar këngët. Ata kanë vepruar drejt kur lëndën e këtij vëllimi e kanë mbarështruar duke e marrë për bazë strukturën poetike të këngëve. Në të vëretetë, libri nuk përmban asnjë ndarje formale, por 353 këngët dhe variantet e tyre janë radhitur e grupizuar në bazë të elementeve të përbashkëta ose të ngjashme të poetikës së tyre. Pra, në këtë radhitje, krahas tematikës dhe motivikës, është

ruajtur me kujdes edhe afërsia e ngjashmëria e strukturës së ndërtimit të këngëve, mjetet stilistike dhe figurative me të cilat janë realizuar ato, si dhe ndjenjat, idetë dhe preokupimet e heronjve lirikë të tyre. Kështu, shikuar si tërësi, ky libër paraqet një mozaik në përmasa të gjera që përfshin tërë bukurinë e poezisë popullore shqiptare të dashurisë. Në pjesët e veçanta të këtij mozaiku me nuanca të shumta të ngjyrave, herë plot zjarr optimist, herë të buta e mallëngjyese, e madje edhe elegjiake, poezia e dashurisë e ka ruajtur suptilitetin e vet lirik dhe vazhdimësinë e natyzyshme tematiko-motivore të këngëve.

Një çështje tjetër që i ka preokupuar përpiluesit e blenit „Këngë dashurie I” është edhe sensualizmi i theksuar i disa krijimeve poetike të dashurisë. Kjo dukuri është e natyryshme kur kemi parasysh se poeti popullor është frymëzuar drejtpërdrejt nga ndjeshmëria që i takon sferës më intime të botës së brendshme të individit, nga synimet reale për realizimin e dashurisë. Kur dimë se normat e moralit patriarkal me tërë vrazhdësinë e tyre pothuajse në të gjitha trevat shqiptare në të kaluarën e ndalonin dashurinë midis të rinjve para martesës dhe jashtë saj, atëherë del e qartë se situatat e ndryshme të dashurisë që i hasim në këto këngë, në pjesën më të madhe, janë fryt i imagjinatës së të rinjve, e jo përjetime reale të tyre. Në poezinë lirike në përgjithësi është i njohur parimi krijues se sa më shumë pengesa që dalin në realizimin e dëshirave dhe synimeve, aq më vrullshëm shpërthejnë emocionet dhe pasionet në botën imagjinativo-poetike të individit për atë që është e ndaluar dhe e paarritshme. Mu këtu qëndron baza e sensualizmit të theksuar në një pjesë të poezisë erotike shqiptare, por pasionet erotike që manifestohen në disa këngë janë kushtëzuar edhe nga një faktor i jashtëm. Dihet se shumë këngë të zonave malore blegtorale, që janë krijuar dhe ruajtur nga barinjët, janë kënduar vetëm jashtë ambienteve të përditshme familjare, prandaj krijuesi dhe interpretuesi i tyre, duke kënduar maje malesh e kodrinash, në pyje dhe në kullosa, larg vendbanimeve, ka qenë i liruar nga kufizimet e

normave të moralit të përgjithshëm shoqëror dhe i ka dhënë liri të plotë shprehjes së vet poetike. Tekefundit, tradita e këngëve të dashurisë është ruajtur brez pas brezi, prandaj në çdo kohë gjeneratat më të vjetra e kanë toleruar këngën e këtillë të të rinjve, duke konsideruar si ekzistencë të pavarur poetike që ka bukurinë dhe kënaqësinë e vet jashtë realitetit të përditshëm.

Në bazë të zgjedhjes që kanë bërë përpiluesit e blenit „*Këngë dashurie I*”, Rrutem Berisha dhe Myzafere Mustafa, këngët e dashurisë me elemente sensualiste dhe shpërthime të pasioneve erotike, në asnjë rast nuk arrijnë në kufij të banalitetit. Ata kanë vepruar drejt kur, siç thuhet në parathënie „*nuk i kanë bërë censurë dukurisë sensuale-natyraliste*”, që është e pranishme në një numër këngësh, sepse në kushtet e sotme, kur njeriu ynë është liruar nga shumë paragjykime të moralit të së kaluarës, këngët e këtilla, që në radhë të parë janë me interes për studimin e letërsisë popullore, lexohen me ëndje edhe nga lexuesit e ndryshëm. Tekefundit, këto këngë si pjesë e traditës së vetë poetike, vetë populli i ka çmuar dhe i ka ruajtur si vlera të krijimtarisë së tij shpirtërore.

Në blenin „*Këngë dashurie I*” disa nga këngët i kanë edhe nga dy-tri variante. Botimi i varianteve, sidomos kur ato janë shënuar në treva mjaft të largëta nga njëra-tjetra, paraqet interes të veçantë për studimin e letërsisë popullore, sepse nëpërmjet tyre dalin më të plota vlerat artistike të këngëve, vërehet shtrirja e tyre territoriale, mënyra e zhvillimit evolutiv dhe e krijimit të strukturës poetike të këngëve, si edhe karakteristikat e tjera lidhur me unifikimin e koncepteve estetike të interpretuesve dhe të dëgjuesve të këngës popullore në vise të ndryshme. Qëndrimi i drejtë i

përpiluesve të blenit lidhur me variantet që përmbajnë vlera poetike, jo vetëm që duhet të ruhet edhe për vëllimin e dytë të këngëve të dashurisë, i cili parashihet të botohet në të ardhshmen, por konsiderojmë se në këtë vëllim duhet të botohen edhe variantet e reja që janë shënuar më vonë të këngëve nga vëllimi i parë. Në këtë mënyrë lexuesve, e sidomos studiuesve të ardhshëm, do t'u kompletohej lënda shumë e pasur folklorike dhe do t'u prezentohej të gjitha vlerat poetike që përmban poezia popullore shqiptare e dashurisë.

Libri „*Këngë dashurie I*” është pajisur edhe me një fjalorth fjalësh të rralla dhe shprehjesh të ndryshme arkaike e krahinore, i cili ka kryesisht qëllim praktik. Poezia popullore e dashurisë që është paraqitur në këtë ble dëshmon edhe për pasurinë gjuhësore të folklorit tonë. Me interes të veçantë janë sidomos disa kompozita, që kanë funksione të veçanta poetike, të cilat nuk i gjejmë fare në gjuhën letrare shqipe. Përveç fjalorthit, vepra është pajisur edhe me shënime të nevojshme për interpretuesit dhe mbledhësit e këngëve.

Duke marrë parasysh, në radhë të parë, vlerën poetike të krijimeve popullore, punën e përpiluesve për zgjedhjen e mbarështrimin e lëndës, parathënien e shkruar me përkushtim, në fund mund të pohojmë se libri „*Këngë dashurie I*” është botim i rëndësishëm i Institutit Albanologjik të Prishtinës dhe do të shërbejë si bazë për studimin e suksesshëm të lirikës popullore shqiptare. Një botim i këtillë është me interes të përgjithshëm për kulturën tonë shpirtërore. Këtij interesi padyshim i ka kontribuar edhe puna e Dr. Shefqet Pllanës në redaktimin e këtij vëllimi.

SADRI FETIU

Biserka Rajčić (përkthyes), RELIGIOZNI OBREDI, OBIČAJI I SIMBOLI, Beograd 1980, f. 411.

Për mitologjinë, në kuadrin e etnologjisë, sidomos viteve të fundit, është duke u shfaqur një interesim i madh në planin hulumtues dhe studiues, nga dijetarë të këtij lëmi. Një përpjekje të tillë e paraqet edhe li-

bri për të cilin e kemi fjalën: *Zakone, ceremoni dhe simbole religjioze*, shkruar nga një grup autorësh, e i përkthyer nga Biserka Rajčić. Hartuar nga shtatë autorë, në këtë libër trajtohen doke, zakone e ceromoni